



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

LISTË VERIFIKIMI - OPERATOR TURISTIK

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI - OPERATOR TURISTIK

Në zbatim të Ligjit Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, VKM nr. 710, datë 12.10.2016 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”, i ndryshuar.

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Pika 1, neni 51, Ligji Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.	Operatori turistik është i pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
2	Pika 1 dhe 2, neni 53, Ligji Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar.	Operatori turistik a e ka raportuar elektronikisht regjistrin me të dhënat e turistëve, destinacionet e vizituara dhe ditët e qëndrimit, një herë në muaj, sipas formularit të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe a i ka ruajtur këto raportime, të specifikuara, për tre vjet, nga data e kthimit nga udhëtimi përkatës?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
3	Pika 1, neni 54, Ligjit Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar	Të dhënat bazë të kontratës së operatorit turistik me udhëtarin a i përmban të gjitha si më poshtë? a) licencën e “Operatorit turistik”; b) emrin, adresën dhe të dhëna të tjera kontakti të agjencisë së udhëtimit, operatorit turistik dhe të siguresit; c) destinacionin e udhëtimit dhe datat e nisjes e të kthimit; ç) mjetin e transportit të përdorur; d) itinerarin e udhëtimit; dh) tipin e strukturës së akomodimit, vendndodhjen, klasifikimin dhe karakteristikat kryesore të saj; e) vaktet e ushqimit, të përfshira në çmimin e paguar; ë) listën e shërbimeve të tjera që ofrohen për klientët brenda çmimit të paguar; f) listën e shërbimeve që nuk përfshihen në çmimin e paguar; g) listën e shërbimeve shtesë, që mund të blihen veçmas; gj) numrin minimal të personave të domosdoshëm për realizimin e paketës së udhëtimit; h) afatin për njoftimin e klientit, në rastin e anulimit nga ana e operatorit turistik; i) afatet dhe penalitetet përkatëse, në rastin e anulimit të shërbimit të blerë nga ana e klientit; j) mundësinë e transferimit të paketës; k) çmimin e paketës së udhëtimit dhe kur paketa lejon rishikim çmimi, një shënim për rishikimin e mundshëm dhe mënyrën e përlllogaritjes së këtij rishikimi; l) tabelën me afatet kohore dhe mënyrën e pagesave; ll) kërkesat e veçanta që klienti ka bërë me dije në momentin e rezervimit dhe për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët; m) përgjegjësitë që dalin nga mospërmbushja e detyrimeve në dëm të klientit; n) formatin e garancisë, shtrirjen dhe limitet financiare të përgjegjësisë; nj) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të komunikuar me klientin nëpërmjet operatorit turistik; o) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të ndihmuar në çdo rast; p) kontaktin e drejtpërdrejtë me personin përgjegjës për fëmijën që nuk është i shoqëruar nga prindërit apo përfaqësuesi i tij ligjor; q) informacion për procedurat e trajtimit të ankesave dhe mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve		

Nr	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi (Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
4	Pikat 1 Neni 64/1, Ligji nr. 93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar.	A është i ekspozuar në vend të dukshëm për publikun emri i biznesit si dhe procedura e ankimit të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze?		
5	Pika 4, Neni 64/1, Ligji nr. 93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar.	A ka një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentin?		
6	Gërma c, pika 2, Neni 66, Ligji nr. 93/2015, "Për Turizmin", i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi për raportimin e të dhënave statistikore mujore për numrin total të vizitorëve për turizmin pritës dhe turizmin në dalje, shtetësinë dhe destinacionin?		
7	Pika 1, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi për ambientin e ushtrimit të veprimtarisë i cili nuk mund të jetë më pak se 16 m ² dhe duhet të jetë i pajisur me pajisje të përshtatshme pune, përfshirë tavolinë pune, karrige, pajisje informatike, duhet të ketë akses në internet, akses në rrjetin telefonik etj?		
8	Pika 2, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	Nëse në mjedisin e punës punojnë më shumë se dy punonjës, sipërfaqja minimale e detyrueshme a është të paktën 4 m ² mbi sipërfaqen minimale të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për çdo punonjës shtesë?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
9	Pika 4, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi sipas të cilit nëse subjekti ofron shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë te klientët fundorë, duhet që: a) në një vend të dukshëm, në pjesën e jashtme të mjedisit të punë, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me emrin e subjektit dhe adresën e tij; b) në hyrje të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me orarin e punës; c) në një vend të dukshëm në brendësi të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë licencën e miratuar nga struktura përgjegjëse; ç) në një vend të dukshëm të afishojë dhe të informojë klientin në lidhje me kushtet, përmbajtjen dhe çmimin për çdo shërbim individual; d) të sigurojë një mënyrë të përshtatshme për depozitimin e ankesave nga klientët, duke përfshirë, por pa u kufizuar, një libër ankesash në mjedisin e punës, adresë elektronike për pritjen e ankesave etj. Dhe, brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, të japë një përgjigje me shkrim?		
10	Pika 5, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	Për shërbimin që ndërmjetëson, operatori turistik a siguron nënshkrimin e një kontrate midis klientit, ofruesit të shërbimit që ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi dhe/ose operatorit turistik, kontratë e cila ruhet nga palët nënshkruese dhe duhet të dokumentojë organizimin e shërbimit?		
11	Pika 6, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi nga subjekti, sipas të cilit çdo paketë udhëtimi, e përgatitur nga operatori turistik, kur shitet te klienti fundor nga operatori turistik, në mënyrë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës ose nëpërmjet komunikimit elektronik, shoqërohet me kontratën e lidhur mes klientit dhe operatorit turistik, sipas legjislacionit në fuqi, e nënshkruar nga palët në formën e printuar ose sipas parashikimeve të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
12	Pika 6, Neni 2, VKM nr. 709, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi nga subjekti, sipas të cilit çdo paketë udhëtimi, e përgatitur nga operatori turistik, kur shitet te klienti fundor nga operatori turistik, në mënyrë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës ose nëpërmjet komunikimit elektronik, shoqërohet me kontratën e lidhur mes klientit dhe operatorit turistik, sipas legjislacionit në fuqi, e nënshkruar nga palët në formën e printuar ose sipas parashikimeve të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik” ?		
13	Pika 7, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi nga subjekti, sipas të cilit kontrata e paketës së udhëtimit shoqërohet gjithmonë me kontratën e sigurimit që mbulon përgjegjësinë e operatorit turistik ndaj palëve të treta për dëmet e shkaktuara si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit?		
14	Pika 8, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi nga subjekti operatori turistik detyrohet të garantojë klientin se, në rast falimentimi, pas lidhjes së kontratës, do të rimbursojë plotësisht vlerën e paguar nga ana e klientit?		
15	Pika 9, Neni 2, VKM nr. 710, datë 12.10.2016, i ndryshuar.	A është përmbushur detyrimi nga subjekti, sipas të cilit operatori turistik është i detyruar që, përgjatë organizimit të një pakete udhëtimi dhe ekskursioni, për më shumë se 10 persona, duhet të angazhojë gjatë tij të paktën një shoqërues udhëtimi dhe përgjatë vizitave në vende të vizitueshme, një udhërrëfyes turistik të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi?		

Nr .	Baza Ligjore	Përshkrimi i objektit	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
16	Pika 10, Neni 2, VKM nr. 709, datë 12.10.2016	A është përmbushur detyrimi nga operatori turistik, për mbrojtjen e të dhënave personale të administruara prej tij në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përfshirë identitetin, adresën, vendin, kohën e udhëtimit, qëndrimin dhe çmimin dhe nuk i përhap të dhënat te palë të treta, pa pëlqimin paraprak të shprehur të klientit, me përjashtim të rasteve kur detyrohet nga ligji ta japë këtë informacion tek organet përkatëse shtetërore?		

INSPEKTORËT